

#FinancëNjerëzore

RAPORT VJETOR 2023



PËRMBAJTJA

- 03 Mesazhi i CEO-s
- 04 Një rrugëtim 25 vjeçar përtej mikrofinancës
- 05 Dega Kosovë, Arritja më simbolike e vitit 2023
- 06 Emetimi për herë të parë në Shqipëri i një obligacioni me ofertë publike
- 07 Nuk jemi një FinTech, por sigurisht lider të inovacionit mikrofinanciar
- 08 NOA, Tanimë një aktor financiar ballkanik
- 09 Një rritje e qëndrueshme dhe njëherazi e përgjegjshme
- 10 Financë Njerëzore do të thotë...
- 11 Një klient që shërbehet mirë, është gjithmonë një klient i mirë
- 12 NOA, një 'one-stop-shop' financiar
- 13 Standarde & bashkëpunime ndërkombëtare, në mbështetje të sipërmarrjes shqiptare
- 15 Në zemër të çdo suksesi, njerëzit
- 16 Struktura Organizative
- 18 Përgjegjësi Sociale në NOA
- 19 Kudo, pranë çdo komuniteti
- 20 Kujdesemi për mjedisin
- 21 Impakt dhe mbështetje sociale
- 22 Që financimet tona të kenë një impakt pozitiv
- 23 Pasqyrat financiare individuale të audituara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 NOA sh.a

Mesazhi i CEO-s



Herjola Spahiu

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, NOA sh.a

Një mesazh drejtuar miqve të NOA,

Ky vit përfaqëson 25 vjetorin e fillimit të aktivitetit tonë financiar. Një datë simbolike që na krenon pasi prej 25 vitesh, angazhohemi t'i shërbejmë ekonomisë shqiptare njëherazi me pasionin e një start-up-i, me profesionalizmin e një banke, dhe devotshmërinë e një misionari.

Saktësisht kështu! Sepse në NOA çdo ekip e çdo bashkëpunëtor drejtohet nga një energji e pamasë në promovimin e bizneseve dhe fermerëve që kërkojnë ndihmën tonë. Mbështeten në një profesionalizëm të konsoliduar ndër vite i cili mbron nga çdo formë keq-kreditimi. Nxiten nga pasioni për sipërmarrjen e lirë, e cila është në themel të mirëqënies së çdo kombi.

Dhe shifrat janë dëshmia më e mirë e këtij përshkrimi, teksa portofoli aktiv e tejkaloi kufirin e 9 miliardë lekëve në përmbyllje të vitit 2023. Një rritje prej 25% krahasuar me vitin e mëparshëm. Numri i klientëve aktivë tejkaloi 16,800 ndërkohë që niveli i kredive jo-performuese (NPL) mbeti në 2.1%. Në paralel me aktivitetin tonë kredidhënës, ekipi ynë arriti të emetonte me sukses obligacionin e parë publik në tregun e titujve në Shqipëri dhe të fillonte aktivitetin kredidhënës në Kosovë. Dhe sikur këto të mos mjaftonin, besnikë ndaj rrënjëve të misionit tonë, gjatë vitit 2023 finalizuam dhe strategjinë tonë ESG duke u vlerësuar me sukses si me certifikatën prestigjioze të mbrojtjes së klientit – CPC, ashtu dhe nga UNDP si një nga bizneset finaliste pionere në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm SDG.

Aktiviteti i këshillimit, pjesëmarrja e vazhdueshme në panairët / seminarët lokale e ato rajonale, si Samiti Ekonomik i Ballkanit, nuk munguan as këtë vit si një vijim natyral i aktivitetit tonë mbështetës në drejtim të politikave publike zhvillimore.

Ishte një vit i jashtëzakonshëm për shkak të zgjerimit numerik e gjeografik, por dhe njerëzor teksa arritëm në 333 punonjës. Besnikë të një #FinancëNjerëzore e cila përfshin individin, familjen e ambiciet sipërmarrëse në çdo proces vendimarrës, investuam gjatë vitit 2023, në 900 orë trajnime duke organizuar po kaq shumë festa, udhëtime, promovime e punësime të reja të cilat pasqyrojnë më së miri frymën unike të bashkëpunimit që mbizotëron mes nesh.

Prandaj përfitoj nga rasti t'i shpreh, edhe në emër të Këshillit Mbikqyrës të NOAs, një falenderim secilit prej punonjësve tanë! Një falenderim për ekipin e ndërtuar, për miqësitë, për solidaritetin, për frymën, për ambiciet, për mbështetjen dhe investimin në ndërtimin e një historie suksesi si kjo që pasqyron sot NOA. Sepse ky është suksesi i tyre. Sepse tek ata, gjenden rrënjët e çdo zgjerimi, arsytet e çdo shifre, energjitë e çdo risie të përshkruar në çdo faqe të këtij raporti.

Ndërsa këtë vit NOA feston 25 vjetorin e saj, krenohemi me shumë suksese! Suksese të njëpasnjëshme në të shkuarën mbi të cilat ndërtojmë të ardhmen tonë të qëndrueshme. Janë momente e kujtime që na bashkojnë dhe që në thelb, janë esenca e asaj që është NOA.

Një rrugëtim 25 vjeçar përtej mikrofinancës.

Përzemërsisht
Herjola

Një rrugëtim 25 vjeçar përtej mikrofinancës

Duke financuar ngritjen dhe zgjerimin e aktivitetit të bizneseve dhe të fermerëve shqiptarë, NOA synon të kontribuojë drejtëpërsëdrejti në përmirësimin e cilësisë së jetesës për mijëra familje që përfitojnë nga rritja e të ardhurave, nga vendet e reja të punës, nga rritja e aktivitetit ekonomik, si në qytetet ashtu në zonat rurale të vendit.

Në këto 25 vite aktivitet, NOA ka provuar se ky model biznesi, financimi i sipërmarrësve dhe fermerit të vogël, financimi i shpejtë dhe pa burokraci për këtë segment të ekonomisë shqiptare, sjell zhvillim e mirëqenie, si dhe përmirësim të jetesës në familjet shqiptare.



Bashkëpunim me USAID në mbështetje të sektorit të tekstilit & lëkurës

2022

2023

Zgjerimi rajonal i NOA edhe në Kosovë



Zhvillimi i Njesisë së Partneriteteve si edhe aktivizimi i marrëveshjeve me kanale alternative të pagesave.

2020

2021

Aktivizim, si i pari institucion financiar në vend, i Njesisë së Contact Point, me qëllim ofrimin e shërbimit më të lartë për klientët e institucionit.

Aksionerët e rinj investojnë në zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit me synim transformimin e NOA-s në një institucionin lider në tregun e mikrofinancës në Shqipëri.

2018

2017

Lëshohen obligacionet e para korporative si edhe nënshkruhet marrëveshja për fondin e garancisë me Fondin Europian të Investimeve



Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) akordon 5 Milion Euro kredi me terma preferenciale për kreditimin e Agrobiznesit.

2016

2015

Institucioni i parë financiar në Shqipëri me një proces kredidhënie totalisht të automatizuar, dhe me këshilltarë financiarë që operojnë me "Tablet" gjatë procesit të shitjes.



Liçensimi nga Banka e Shqipërisë si një Institucion Financiar - jo Bankë.

2007



Themeluar nga USAID dhe regjistruar si një shoqëri e kursim-kreditit.

1999

2001

Fuqizimi i aktivitetit duke u transformuar një shoqëri aksionere

Dega Kosovë, Arritja më simbolike e vitit 2023



Momenti më i rëndësishëm i vitit 2023 për NOA ka qenë hapja e degës së saj në Kosovë. Duke u bazuar tërësisht mbi modelin e biznesit, filozofinë, vlerat dhe teknologjinë e përdorur në Shqipëri, NOA Kosovë është një realitet i cili pasqyron më së miri ambiciet e një ekipi që kërkon të ofrojë më të mirën e mikrofinancës në rajonin e Ballkanit. Dhe rezultatet nuk vonuan. Në mbyllje të vitit 2023, me një ekip në një fazë ende fillestare prej 21 personash, 16 prej të cilëve janë staf vendas, NOA në vetëm 6 muaj operim u ka shërbyer më shumë se **1500 klientëve** me një total portofoli prej **2.5 milionë euro**.



Emetimi për herë të parë në Shqipëri i një obligacioni me ofertë publike

NOA ka qenë i pari institucion financiar shqiptar që emetoi Obligacionin e parë me ofertë publike, në Qershor 2023 me një vlerë **500,000,000 Lekë**.

Obligacioni i parë me ofertë publike u nënshkrua 100% e shumës së emetuar. NOA e bëri të mundur këtë emetim në bashkëpunim me bankën Credins si nënshkrues i titujve, bursës shqiptare të titujve ALSE dhe mbështetjes nga AMF dhe Banka e Shqipërisë. Ky besim për të përqafuar dhe përcjellë risi financiare në tregun shqiptar vjen nga filozofia unike që drejton të përditshmen e aktivitetit të NOA. Themeluar para **25 vitesh** nga USAID, NOA është një institucion që edukimin e tregut, promovimin e praktikave të mira, investimin në inovacione biznesi apo teknologjike në shërbim të ekonomisë, i konsideron të gjitha si pjesë të misionit të saj themeltar.




Nuk jemi një FinTech, por sigurisht që lider të inovacionit mikrofinanciar

Viti 2023 konfirmoi ndjesinë pozitive që klientët e NOA kanë ndaj teknologjive të reja, nivelin e përdorimit dhe impaktin në zgjerimin e aktivitetit gjatë vitit 2023. Kështu, shkëmbimet digjitale janë rritur me **34%** krahasuar me 2022 duke arritur shifrën e **249,443** ndërveprimesh. Numri i përdoruesëve të hapësirës digjitale të klientit "Llogaria ime" është trefishuar duke kaluar nga **577** në **1837** përdorues në vitin 2023, çka përfaqëson **11%** të numrit total të klientëve aktivë. Një rritje inkurajuese, por që dëshmon për një hapësirë ende me potenciale të mëdha.



Kanalet e NOA-s garantojnë mundësinë e aplikimeve 24/7 anëmbanë vendit qofshin ato online, nëpërmjet telefonit apo dhe takimit pranë mjediseve të biznesit/fermës, falë teknologjisë së tabletave biometrike të përdorura nga oficerët e kredisë së NOA. Numri i aplikimeve online në fund të 2023 ka arritur shifrën e **4,284** ndërkohë që aplikimet nga rrjeti i partnerëve kanë arritur në **9,322** (+**167%** krahasuar me 2022).




Viti 2023, për sa i përket shërbimit të identifikimit biometrik të klientëve në distancë, u ndikua nga ndryshimet institucionale të ofruesit të shërbimit Aleat. Numri i verifikimeve biometrike digjitale për vitin 2023 ra në **420** për shkak se ky shërbim rreshti së ofruari nga kompania Aleat duke filluar prej muajit Maj 2023, për shkak të largimit nga Shqipëria. Thënë kjo, oficerët e kredisë vazhdojnë t'u mundësojnë çdo sipërmarrësi e fermeri të aplikojnë për një financim nga terreni, falë përdorimit të **76** tabletave mobile të cilat vijnë të përdoren normalisht për një aplikim në distancë.



Investimet teknologjike të NOA ndjekin dy drejtime kryesore. Së pari në drejtim të përmirësimit të eksperiencës së përdoruesëve e klientëve që kërkojnë financim, dhe së dyti në drejtim të rritjes së efencave të brendshme për të mundësuar konsolidimin e një institucioni sa më të sigurtë dhe efikas në terma digjital. Gjatë vitit 2023 NOA u investua specifikisht në përditësimin e sistemeve qendrore si dhe të sistemeve të partnerëve. Në paralel, filluan dhe përgatitjet teknike për zhvillimin e firmës elektronike dhe të NOA-App për klientët e NOA.

NOA, Tanimë një aktor financiar ballkanik

Forumi Ekonomik Ballkanik BEF i cili u mbajt në Tiranë në 17 Nëntor 2023, ishte një nga momentet e forta të rolit ndërgjegjësues që NOA kërkon të luajë në drejtim të promovimit të një zhvillimi të qëndrueshëm për Shqipërinë. Si i vetmi partner lokal i forumit, NOA mbështeti krijimin e një hapësire unike shkëmbimi që solli së bashku ekspertë nga mbarë rajoni ashtu si dhe përfaqësues nga Komisioni Europian, Banka Botërore, BERZH e USAID, FAO etj.




Një rritje e qëndrueshme dhe njëherazi e përgjegjshme

Totali i portofolit aktiv në fund të vitit 2023 u rrit me rreth **25%** krahasuar me një vit më parë duke arritur në 9 miliard lekë (**82.8 milion euro**). Financime të cilat kanë mbështetur mbi **16.800 klientë** të çdo grup-moshe, sipërmarrës e fermerë, familje dhe individë që kanë gjetur tek NOA zgjidhjen e nevojës së tyre konform profilit dhe realitetit të tyre të përditshëm .

Sot NOA ofron **36 produkte** e procese financimi për secilën prej fashave që mbulon, duke garantuar jo vetëm një akses në financë të ku(r)dondodhur, por dhe për çdo projekt, fazë, segment e grupim socioekonomik. Përtej financimit, NOA u mundëson klientëve shërbime këshillimi dhe partneriteti duke u siguruar që kjo të sjellë një vlerë të shtuar në çdo hap të biznesit të tyre, nga konceptimi, realizimi e deri në mbështetje të shitjeve fundore.

Në këtë drejtim, vlen të theksohet se në fund të vitit 2023, NOA numëron **533 partnerë** të cilët janë mbështetur duke financuar mbi **5.600** shitje për një volum prej **3.9 milion** eurosh.

Aktiviteti në shifra



NOA ka dëshmuar një rritje të qëndrueshme gjatë viteve të fundit bazuar mbi kombinimin e një sërë faktorëve. Mund të citohen si shembuj një shpërndarje e diversifikuar e portofolit financiar, zbatimi i investimeve konstante në burimet njerëzore dhe në teknologjitë e reja, si dhe promovimi i një vizioni drejtues solid, elementë që janë bazuar gjithnjë mbi objektivat e performancës në çdo hallkë e nivel të kompanisë. Kjo ka bërë që çdo klient e çdo staf i NOA të marrë përherë më të mirën. Së pari një standard unik dhe një shërbim cilësor, por dhe mundësi rritjeje, shpejtësi në dhënien e kredisë dhe shpërblim dinjitoz.


Një shërbim që ofrohet njësoj ku(r)do pavarësisht lokacionit, segmentit të tregut apo nivelit hierarkik në kompani. Kjo është arritur falë vendosjes në radhë të parë të njerëzores, sociale, të përbashkëtës që lidh çdo degë të rrjetit NOA me komunitetet që shërbejnë. Një rrjet dhe një ekip që në përmbyllje të vitit 2023 arriti në **333 persona**.

Çdo arritje në këtë raport i dedikohet vetëm atyre!

Financë Njerëzore do të thotë...


Prej 25 vitesh, NOA konsiderohet si lider i financimit të biznesit të vogël dhe fermerit shqiptar, duke arritur në fund të vitit 2023 një shifër prej **66.4 milion** euro portofol financimi aktiv për këto dy segmente. Një portofol që përmbledh **6.541** të vetëpunësuar, pronarë sipërmarrjesh e fermerë të shtrirë anembanë vendit në zona rurale e urbane. Për bujqësinë në veçanti, portofoli aktiv ka arritur në **16.58 milion** euro me një ndryshim nga **+21%** nga viti i kaluar. Ndërkohë për biznesin, portofoli i kredisë është rritur gjatë 2023 gjithashtu me **+20%** duke arritur vlerën e **49.8 milion** eurove.

Portofoli i kredisë sipas Segmenteve në % Dhjetor 2023



NOA financon një sërë sektorësh dhe ka diversifikim të portofolit në lidhje me sektorët që financon. Shërbimet zenë peshën më të lartë me **30%** të portofolit (këtu përfshihet edhe transporti), tregtia zë **21%** të portofolit e shoqëruar më pas nga Agrikultura **17%**, prodhimi **6%** dhe ndërtimi vetëm **4%** etj.


Sektoret e financuar Dhjetor 23




- Prodhimi
- Tregtia (përfshin shitje me pakicë)
- Agrikulturë (bujqësi dhe blegtori)
- Shërbimet (përfshijnë transportin)
- Ndërtimi
- Të tjera

Besnike ndaj misionit të saj social për të garantuar një akses në financë të përhershme për çdo komunitet të diskriminuar për shkak të pozitive gjeografike apo sociale, NOA është një institucion financiar i cili investohet në monitorimin e impaktit që financimet e saj kanë në shoqëri. Kështu, gjatë vitit 2023, mbi **35%** e klientëve të saj ishin gra, **17%** ruralë, dhe **76%** e totalit të disbursimeve u kryen nga degët e rretheve.

Gjinia e Klientëve



Gjeografia e Klientëve



Një klient që shërbehet mirë, është gjithmonë një klient i mirë

NOA ka realizuar një rritje dyshifrore gjatë tre viteve të fundit duke ruajtur një nivel të qëndrueshëm të riskut të kredisë e cila ka çuar në një cilësi portofoli të mirë dhe të menaxhueshme, pavarësisht promovimit të produkteve financiare që shpesh herë shoqërohen me lehtësira në dokumentacion dhe pa kolateral.

Eksperienca dhe profesionalizmi i stafit në vlerësimin e riskut të kredisë, menaxhimin dhe ruajtjen e cilësisë së portofolit, kombinuar dhe me politika dhe procedura të riskut që promovojnë përfshirjen financiare sa më të gjerë për familjet dhe bizneset shqiptare, menaxhimin e marrëdhënieve të klientëve në të gjithë rrugëtimin e tyre me NOA, reflektuan një mbyllje të vitit 2023 me një PAR30+ prej 3.4% (vs. 3.5% në 2022), si dhe një PAR90+ prej 2.1% (vs. 2% në 2022).



NOA, një 'one-stop-shop' financiar




Viti 2023 i përkon dhe konsolidimit të shërbimit të pagesave utilitare pranë çdo dege NOA. Dhe pse shihet ende si një risi, klientët e NOA-s mund të paguajnë një sërë shërbimesh të cilat kanë si fokus në veçanti zonat rurale e ato me qasje të limituar në institucionet financiare. Kështu, në fund të vitit 2023, numri i pagesave utilitare arriti në **705 pagesa**.

78
ankesa

7.6
ditë mesatare
adresimi

NOA respekton vlerat e një institucioni financiar i cili bazohet mbi modelin e një #FinanceNjerëzore. Një koncept që shkon përtej avantazheve konkurrionale e sociale dhe që përfshin dhe garantimin e mundësisë për çdo përfitues të financimeve të NOA-s për të denoncuar çdo praktikë abuzive, shkelje të termave kontraktuale, sjellje jo-etike apo jo-profesionale.

Kjo nënkupton ndërtimin e mekanizmave dhe procedurave të mirëfillta e të mirë-përcaktuara, konform standardeve më të mira të sektorit financiar. Ndërkohë që në vitin 2022, numri i ankesave ishte 5.5 për çdo 1000 klientë), në vitin 2023 numri i ankesave ka arritur në **4.3** për çdo 1000 klientë). Koha mesatare e adresimit të këtyre ankesave është **7.6 ditë**, dhe mbetet brenda të gjitha afateve kohore zyrtare të përcaktuara nga kuadri rregullator i brendshëm dhe i jashtëm. Theksojmë se NOA u certifikua në vitin 2023 sipas standardit më të lartë European të mbrojtjes së klientit 'CPC (lexo më poshtë).



Rritja e mobilitetit dhe e numrit të institucioneve të ndryshme financiare ndërmjetëse, si ato të pagesave dhe të shkëmbimit valutor, ka bërë që shumë klientë, në veçanti ato në zonat rurale, të preferojnë të shlyejnë detyrimet e tyre ndaj NOA-s duke paguar pranë këtyre agjencive ndërmjetëse.

Me qëllim uljen e kostove për klientët dhe të ofrimit të një shërbimi gjithmonë e më miqësor, NOA ofron partneritet me disa institucione pagesash, nëpërmjet të cilave në vitin 2023 u kryen 65% të pagesave ndaj saj, ku 3 kryesorët janë Posta Shqiptare, rrjeti i EasyPay dhe UnionNet. Trajtë domethënëse e tipologjisë së shërbyer nga NOA, vetëm 12.5% e klientëve i paguajnë këstet e tyre nëpërmjet sistemit bankar.

Standarde & bashkëpunime ndërkombëtare, në mbështetje të sipërmarrjes shqiptare

“Erasmus for young Entrepreneurs” është një program shkëmbimi ndërkufitar i cili u jep sipërmarrësve të rinj dhe aspirues, përfshirë edhe ata që kanë një ide novatore biznesi (NE, New Entrepreneurs – Sipërmarrësit e Rinj), mundësinë për të mësuar nga sipërmarrës me eksperiencë (HE, Host Entrepreneurs – Sipërmarrës me eksperiencë (Pritës) dhe që drejtojnë biznese në vendet e tjera pjesëmarrëse të Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

- Në këtë program janë të përfshira **45 shtete** nga Europa dhe më gjerë.
- Një Partneritet i përbërë nga **10 partnerë dhe 9 shtete** të ndryshme si: Italia, Spanja, Bullgaria, Armenia, Letonia, Lituania, Holanda / Franca, Shqipëria dhe Turqia
- do të mbështesë shkëmbimin e **40 sipërmarrësve**, nga të cilët **20 sipërmarrës të rinj** (NE) (përfshirë edhe start-up-e) dhe **20 sipërmarrësit pritës** (HE)
- periudha e shkëmbimit dhe qëndrimit në vendin në të cilin bëhet shkëmbimi përcaktohet në një afat nga **1-6 muaj**
- Nuk ka asnjë kufizim sektorial, pra janë të përfshirë të gjithë sektorët
- Periudha e zbatimit të projektit **4 vite** (01 Shkurt 2023 - 31 Janar 2027)

Ky projekt mbështetet dhe financohet nga Bashkimi Evropian.

Erasmus for Young
Entrepreneurs



Funded by
the European Union



Si një institucion themeluar nga USAID 25 vite më parë, rifillimi i bashkëpunimit mes NOA dhe USAID gjatë vitit 2023 në kuadër të nismës FALP (financimi i sektorit tekstil e lëkurë), përmbante një simbolikë jo vetëm institucionale por dhe sektoriale, duke i mundësuar NOA-s të promovonte për herë të parë një produkt financiar të dedikuar vetëm për sektorin fason dhe rritjes së kapaciteteve të një numri kompanish lider në punësimin e grave në Shqipëri. Përpos financimit, nisma ofron dhe trajnime për kompanitë përfituese, duke u siguruar për një investim sa më të mirëmenduar.

Në kuadër të këtij projekti deri në fund të muajit **Dhjetor 2023**:

- janë **financuar 29 SME**
- me një volum prej rreth **1.5 milion USD**
- janë trajnuar **47 SME**
- me një numër stafi total prej **570 punonjës**

Partnerët e NOA ndihmuan aktivitetin financiar duke injektuar gjatë vitit 2023 rreth 12 milion euro në mbështetje të linjave të kreditimit të ofruara drejt komuniteteve të shërbyera nga NOA.


Gjatë vitit 2023, veçohet dhe financimi i parë i Proparco (grupi publik francez AFD) në Shqipëri i cili u përfitua nga NOA me një vlerë prej 3 milion eurosh.



Në zemër të çdo sukseesi, njerëzit



Në vitin 2021, NOA solli një benefit të ri shtesë për punonjësit e saj, Fondin e Pensionit Vullnetar, një benefit shumë i rëndësishëm, i cili synon rritjen e mirëqënies së stafit në moshën e pensionit. Përgjatë tri viteve NOA ka 3-fishuar kontributin e saj ndaj punonjësve, gjë që ka ndikuar në rritjen e numrit të pjesëmarrjes në fond me 70%.




NOA është mikrofinanca e parë që ka aplikuar orarin e punës të reduktuar për ditën e premtë, gjatë muajve të verës 2023, iniciativë e cila synon të jetë permanente përgjatë gjithë vitit në vijim. Kjo iniciativë vjen në kuadër të nismave tona incentivuese për punonjësit bazuar në praktikën më të mirë të punës si dhe për të mbështetur mirëqenien dhe balancën jetë-punë të punonjësve si çelësin e suksesit tonë.



Në 2023, NOA lançoi programin e "Besnikërisë në Punë". Përgjatë rrugëtimit tonë 25 vjeçar shumë punonjës të rinj na janë bashkuar, por ne kemi arritur të rrenjosim dhe përcjellim vlerat tona më të forta nëpërmjet atyre që i kanë qëndruar besnikë institucionit ndër vite dhe e kanë pasuruar këtë rrugëtim me dedikim të pakursyer dhe energji të pashteruar duke e shndërruar NOA-n në një familje të madhe. Ndaj ne vendosëm të festojmë besnikërinë e tyre ndaj institucionit, në një event të dedikuar mirënjohjes, i pari i këtij lloji për ta vijuar me të tjerë nisma gjatë vitit.

Struktura Organizative





22 module trajnimi

250 pjesëmarrës në trajnime

900 orë trajnime

19 promovime së brendshmi, nga të cilat 7 në pozicione senior/manaxheriale

10% të punësimeve nga internshipet

Regional Challenge Fund for Western Balkans. NOA nënshkroi një marrëveshje partneriteti në kuadër të RCF me Universitetin Metropolitan të Tiranës, me qëllim ofrimin e programeve zhvillimore profesionale/trajnuese të cilat ofrohen nga institucione edukimi dhe Kompani në Ballkanin Perëndimor. Ky është një projekt që mbështetet nga institucione gjermane të zhvillimit, përfshirë GIZ dhe ka të bëjë me edukimin në fushën e Digital Finance. NOA në bashkëpunim me Universitetet, do të bashkë-dizenjojë një program 9 mujor trajnimi, përfshirë kurrikula, trajnim dhe internship për studentët në nivel bachelor. Studentët që do të jenë të suksesshëm mund të përzgjidhen për punësim nga NOA.

NOA është mikrofinanca e parë që ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës në kuadër të projektit "Your Job". NOA mbështet aktivisht komunitetin dhe veçanërisht punësimin e të rinjve, duke ju krijuar mundësi për një karrierë të suksesshme dhe zhvillim personal dhe profesional. Prej 7 muajsh Redona i është bashkuar skuadrës tonë në NOA falë këtij bashkëpunimi.



NOA në mbështetje të të rinjve dhe edukimit e zhvillimit të tyre tregon kujdes të veçantë duke marrë pjesë aktivisht në aktivitete/panaie/bashkëpunime të cilat kanë qëllim informimin, zhvillimin e të rinjve, nxitjen e punësimit, zbulimin e talenteve dhe orientimin e tyre drejt një karriere të suksesshme. Falë këtyre bashkëpunimeve në vitin 2023, 10% e punësimeve në institucion kanë ardhur nga internshipet/praktikat mësimore.

Përgjegjësi sociale në NOA



- MFR company rating (a-High) (Janar 2023)

Si një institucion që operon konform "Kodit të Praktikave të Mira të Mikrofinancës" të Komisionit Europian i cili imponon dhe një nivel transparence korporative të lartë, në Janar 2023 NOA u vlerësua në rrafshin e aktivitetit financiar e menaxherial nga agjencia ndërkombëtare e ratimit MFR me vlerësimin "a- e lartë".

Ky vlerësim e vendos perspektivën institucionale të NOA-s në nivelet më të larta duke konfirmuar dhe bazat e shëndosha mbi të cilat u arrit rritja e portofolit të financimit gjatë vitit 2023 me rreth 25%.



- Client Protection Certificate (Silver) (Dhjetor 2023)

#FinancëNjerëzore për NOA është një angazhim institucional në ofrimin e standardeve më të larta për çdo klient përfitues, pavarësisht lokacionit, moshës apo formimit profesional.

Certifikimi i NOA-s gjatë vitit 2023 nga agjencia ndërkombëtare e ratimit MFR si konform standardeve të "CPC – Client Protection Certificate" (Certifikatë e Mbrojtjes së Klientëve) është dëshmia më e lartë e investimit të NOA-s në drejtim të mbrojtjes së klientëve të saj nga mbi-kreditimi, të transparencës së produkteve të ofruara, të mbrojtjes së të dhënave personale të klientëve etj.



NOA, finaliste e 'SDG Business Pioneer Award'

Si pjesë e angazhimeve ESG, NOA është një institucion i cili përfaqëson objektivat e vendosura nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në shërbim të një zhvillimi socio-ekonomik të qëndrueshëm.

Në këtë drejtim, ishte vlerësimi i NOA në 2023 si një ndër tre institucionet finaliste të konkursit organizuar nga UNDP "SGD Business Pioneer Award", ishte një konfirmim i mirëpritur i investimit të institucionit.

Finaliste krahas Bankës Credins dhe Grupit Balfin, ky konkurs konfirmon pozicionimin e NOA si një ndër institucionet financiare lider në vend në promovimin e standardeve më të larta mjedisore, sociale dhe të qeverisjes korporative.

Kudo, pranë çdo komuniteti



Viti 2023 numëron 16 aktivitete në drejtim të biznesit si një dëshmi e rëndësisë që NOA i jep kontaktit të përditshëm me realitetet e tregut dhe të bizneseve shqiptare. Organizimi i seminareve trajnuese, pjesëmarrje në panairë biznesi, promovimi i forumeve ekonomike etj. NOA investohet fuqimisht në përhapjen e një kulture dialogu, shkëmbimesh e rritjesh kapacitetesh për bizneset shqiptare si elementë kritikë e shoqërues për çdo financim që injekton në ekonominë shqiptare.



Kujdesemi për mjedisin

NOA investohet të ulë sa më shumë impaktin në mjedis duke futur praktika të reja eko-inteligjente, të cilat reduktojnë si shembull numrin e printimeve nëpërmjet përdorimit të firmës elektronike për çdo dokument të brendshëm, ulja e përdorimit të kartvizitave të printuara dhe përdorimi i email signature, përdorimi i kodit për printimet dhe sensibilizimin e përdoruesve që të mos printohet asgjë nëse nuk është vërtet e nevojshme, fikje automatike të pajisjeve elektronike duke ulur kostot e energjisë etj.



Këto praktika kanë bërë që gjatë vitit 2023, totali i printimeve të jetë ulur me 20% krahasuar me një vit më parë.



Implementimi i firmës elektronike në funksionimin e brendshëm të NOA-s është një hap i cili nxit kulturën digjitale në mënyrën e trajtimit të dokumentave të brendshëm (ulje e hapësirës për arkivim, konfirmim i përshpejtuar, komunikim mes çdo ekipi, mos-printim por duke rritur transparencën etj.) por gjithashtu hedh gurthemet e nevojshme për një marrëdhënie kontraktuale tërësisht digjitale edhe me klientët.

Në tërësi, viti 2023 arriti një rekord të firmave, dokumentave të konfirmuara në mënyrë digjitale, çka ka patur dhe një impakt në gjurmën mjedisore të NOA.


Dokumeta të nënshkuara elektronikisht



Impakt dhe mbështetje sociale

Ekipi i NOA-s organizoi 12 aktivitete me karakter social gjatë vitit 2023.

Nisma si ajo e EIPASS për muajin e autizmit; bashkëpunimi me Down Syndrome Albania; dhurime librash, ushqimesh e veshjesh; dhurimi i gjakut apo mbështetje të kauzës së fëmijëve; mbjellje pemësh; mbështetja e kauzave sociale nga NOA merr forma të ndryshme si një pasqyrë e shumëllojshmërisë së komuniteteve me të cilat ndërveprojnë stafi i NOA-s në të përditshmen e tyre.



Që financimet tona të kenë një impakt pozitiv



Këshillimi është një nga tre kolonat e shërbimit të ofruar nga NOA krahas financimit dhe partneriteteve. Një risi e viteve të fundit, në vitin 2023 NOA promovoi 35 këshillime agro & 14 këshillime biznesi, të cilat shpërndahen falas dhe në një mënyrë digjitale drejt klientëve të NOA.



Në vitin 2023, 20 aplikime janë refuzuar për arsye mos-respektimi të normave të brendshme të NOA. Dhe pse NOA ofron një fleksibilitet të lartë në produktet financiare të saj, kjo vjen me një politikë strikte përjashtuese ndaj një sërë aktiviteteve që konsiderohen të dëmshme për natyrën, për trashëgiminë kulturore etj. Është pikërisht kjo qasje sociale e përgjegjshme që bën që çdo vit të refuzohen në mënyrë kategorike aplikimet për financim që nuk respektojnë këto norma.



Një ndër akset e reja prioritare në NOA, financimi ekskluzivisht për eficientë energjetike në vitin 2023 ka arritur nivelin e 225 mijë eurove. Një shifër kjo relativisht e ulët por që kompensohet nga fakti se financimi i NOA-s për investime në asete fikse biznesi e bujqësore në 2023 kapi vlerën e 26.3 milion euro (portofol aktiv), ku shpesh herë, investimi përmban një sërë zërash ku përfshihen dhe punime në termoizolim dhe mjediseve të biznesit, instalimin e paneleve etj.

Fushata Kreditim i Zgjuar 2023



Për të disatin vit radhazi, NOA është bashkuar fushatës për Kreditimin e Zgjuar me tematikë "Mikrofinanca për gratë sipërmarrëse". Kjo fushatë e organizuar nga Qendra e Mikrofinancës (MFC), u fokusua në promovimin e praktikave të përgjegjshme të huamarrjes dhe ruajtjes së standardeve të mbrojtjes së klientëve në industrinë mikrofinanciare. Edicioni i 9-të i Fushatës "Kreditim i Zgjuar" nënvizoi rëndësinë e fuqizimit të grave sipërmarrëse dhe nxitjes së një kulture të huadhënies së përgjegjshme.

PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

Për më shumë informacion klikoni në:
<https://noafin.al/media/662f8066ef0a0.pdf>

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionarët e NOA sh.a.,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të NOA sh.a., (më tej referuar si "Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2023, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2023 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standarde të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurën të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të shoqërisë.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tirana, Albania
11 prill 2024



Pasqyra individuale e Pozicionit Financiar
(Shumat në mijë Lekë)

Aktivitet	Shënime	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	16	763,531	608,745
Hua institucioneve financiare	17	223,425	105,563
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	18	8,596,995	6,913,435
Tatim fitimi i parapaguar		2,069	-
Aktive të qendrueshme të trupezuara dhe aktive me të drejtë përdorimi	19	245,435	184,017
Aktive të qendrueshme të patrupëzuara	20	13,044	18,329
Inventari dhe aktive të tjera	21	140,998	90,488
Investime në filial	22	35,031	35,031
Aktive të shtyra tatimore	15	27,812	24,644
Totali i aktiveve		10,048,340	7,980,252
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrimet			
Hua	23	6,915,604	5,605,951
Obligacione	24	493,201	-
Grante	25	12,762	-
Detyrime të tjera	26	286,372	239,010
Tatim fitimi i pagueshëm	15	-	16,915
Totali i detyrimeve		7,707,939	5,861,876
Kapitali			
Kapitali i paguar	27	731,838	731,838
Rezerva ligjore	28	73,184	73,184
Fitime të mbartura		1,535,379	1,313,354
Totali i kapitalit		2,340,401	2,118,376
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		10,048,340	7,980,252

Pasqyra individuale e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 56 dhe që janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare individuale.

Pasqyra individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse
(Shumat në mijë Leke)

	Shënime	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Të ardhura nga interesat	8	1,846,687	1,479,629
Shpenzime për interesa	9	(522,173)	(336,396)
Të ardhura neto nga interesat		1,324,514	1,143,233
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	10	123,646	103,047
Shpenzime për tarifa dhe komisione	10	(2,706)	(2,276)
Tarifa dhe komisione neto		120,940	100,771
Rimarrja nga kreditë e fshira	11	94,511	94,185
Të ardhura nga shitja e portofolit		25,973	-
Të ardhura të tjera	12	18,026	13,288
Të ardhura operative neto		1,583,964	1,351,477
Shpenzime personeli	13	(490,150)	(423,588)
Shpenzime operative të tjera	14	(224,798)	(187,652)
Humbje nga provizioni i huave dhe paradhënies për klientët	11	(267,934)	(196,047)
Shpenzime zhvlerësimi	19	(91,573)	(70,911)
Shpenzime amortizimi	20	(8,892)	(9,348)
Humbja neto nga kursi i këmbimit		(535)	8,161
Shpenzime totale operative		(1,083,882)	(879,385)
Fitimi para tatimit		500,082	472,092
Tatimi mbi fitimin	15	(78,487)	(72,821)
Fitimi për vitin		421,595	399,271
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		421,595	399,271

Pasqyra individuale e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 56 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale.

Pasqyra individuale e Flukseve të Parase
(Shumat në mijë Leke)

	Shënime	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2023
Flukset e parasë nga aktivitetet operative:			
Fitimi për vitin para taksës		500,082	472,092
Rregullimet për:			
Shpenzime zhvlerësimi	19	91,573	70,911
Shpenzime amortizimi	20	8,892	9,348
Shpenzimi financiar për detyrimet e qirasë	26	9,560	6,103
Humbje nga nxjerrja nga përdorimi i aktiveve		-	9
Humbje nga zhvlerësimi i kredive ndaj klientëve	11,1	267,934	196,047
Fitim/(Humbje) neto nga kursi i këmbimit		43,044	(8,161)
Të ardhura nga interesa	8	(1,846,687)	(1,479,629)
Shpenzime për interesa	9	512,613	330,293
Ndryshime në			
Hua dhe paradhënie klientëve		(1,951,494)	(1,227,336)
Hua institucioneve financiare		(117,862)	61,612
Aktive të tjera		(50,510)	(23,958)
Detyrime të tjera		82,393	(4,063)
		(2,450,462)	(1,596,732)
Interes i arkëtuar		1,802,239	1,324,896
Interes i paguar		(512,613)	(320,527)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(100,640)	(66,416)
Mjetet monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ, neto		(1,261,476)	(658,779)
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese:			
Bterje të aktiveve të qendrueshme të trupëzuara	19	(53,135)	(38,106)
Blerje të aktiveve të qendrueshme të patrupëzuara	20	(3,606)	(1,536)
Investim në filiale		(35,031)	-
Mjete monetare të përdorura në aktivitetet investuese, neto		(91,772)	(39,642)
Flukset e parasë nga aktivitetet financiare:			
Hyrje nga huatë	6f	3,458,921	3,456,135
Pagesa nga huatë	6f	(2,149,268)	(2,411,655)
Ripagimet e detyrimeve të qirasë	26,2	(64,735)	(50,760)
Hyrje nga obligacione		493,201	-
Hyrje nga grantet		12,762	-
Dividende të paguar	27	(199,570)	(156,538)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktivitetet financiare, neto		1,551,311	837,182
Rritje të mjeteve monetare dhe ekuivalente me to, neto		198,063	138,761
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	16	608,745	451,896
Diferencë neto nga kursi i këmbimit		(43,277)	18,088
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	16	763,531	608,745

Pasqyra individuale e flukseve të parase duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 56 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
(Shumat në mijë Leke)

	Kapitali Aksionar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Mbartura	Total
Gjendja më 1 Janar 2022	731,838	64,027	1,079,778	1,875,643
Fitimi për vitin	-	-	399,271	399,271
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	399,271	399,271
Transferim i fitimit të mbartur në rezervën ligjore	-	9,157	(9,157)	-
Dividende	-	-	(156,538)	(156,538)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	9,157	(165,695)	(156,538)
Gjendja më 31 Dhjetor 2022	731,838	73,184	1,313,354	2,118,376
Fitimi për vitin	-	-	421,595	421,595
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	421,595	421,595
Transaksione me pronarët e Shoqërisë	-	-	-	-
Transferim i fitimit të mbartur në rezervën ligjore	-	-	-	-
Dividende	-	-	(199,570)	(199,570)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	(199,570)	(199,570)
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	731,838	73,184	1,535,379	2,340,401

Këto pasqyra financiare individuale u miratuan nga drejtimi i shoqërisë më 8 Prill 2024 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


Heriolla Spahiu
Drejtor Ekzekutiv




Arida Ceta
Drejtor i Financës

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 56 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale.

